



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.14.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË
PRIZRENIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës ekipi) Ernes Beka dhe Fetah Osmani (anëtarë ekipe), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	27
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	28
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	31
Shtojca IV: Letër konfirmimi	36

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Komunës së Prizrenit për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 15.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më gjerësisht, shih Shtojcën 1.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Prizrenit

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se ishin bërë 2,227,559€ keqklasifikime nga kategoria investime kapitale për mallra dhe shërbime dhe subvencione dhe transfere. Poashtu, regjistri i pasurive financiare nën 1,000€ nuk ishte i plotë.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”


Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Bazuar në çështjet e ngritura në brendësi të raportit, konkluzioni i përgjithshëm është se sistemi i kontrollit të brendshëm, i vendosur nga komuna, funksionon por jo në nivelin e duhur. Pra ekzistojnë dobësi në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2016

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale dhe
- Deri në fund të muajit janar 2018, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Kemi audituar PFV-të e Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se janë bërë klasifikime të shpenzimeve në kode të gabuara. Nga pagesat e testuara kemi vërejtur se komuna nga kategoria ekonomike investime kapitale kishte paguar 2,227,559€, të cilat për nga natyra janë mallra dhe shërbime dhe subvencione dhe transfere. Prej tyre më kryesoret janë: grumbullimi dhe menaxhimi i

mbeturinave (1,079,132€), mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve (474,955€), subvencionim për klubin futbollistik Liria (100,000€), transporti i arsimitarëve (48,770€), furnizim me far gruri, misri, folio plastike (102,122€), etj. Kjo shumë ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2016 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale. Gabimet kanë të bëjnë me gabime në planifikimet fillestare nga komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

Po ashtu, regjistri i pasurive financiare nën 1,000€ nuk është i plotë për shkak se në të nuk janë të përfshira pasuritë e shkollave, Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, dhe të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PVF-të

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PVF-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PVF-të në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PVF-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PVF. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PVF, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Pasqyrat nëntëmujore financiare; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë;

Sa i përket kërkesave më lartë, komuna i kishte trajtuar dhe është në pajtim me kornizën raportuese.

Nga aspekti i cilësisë, draft PFV-të fillestare kanë pas nevojë të korrigjohen për shkak se përmbanin disa gabime dhe mangësi informatash. Ato janë korrigjuar, me përjashtim të çështjeve të pasurive dhe keqklasifikimit për të cilat çështje ne e kemi theksuar opinionin. Për më shumë, shih nënkapitullin 1.1 Opinioni i auditimit.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale përveç çështjeve të përmendura në opinion e auditimit.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes dhe të vendos procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha dobësitë që ndërlidhen me PFV.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo pasqyron veprimet e marra të menaxhmentit në zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve ekzistuese dhe kontroleve. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes të komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa pohime pozitive mbi ekzistimin e këtyre aranzhimeve por që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Komuna nuk kishte arrit t'i zbatojë në shkallën e mjaftueshme rekomandimet e vitit të kaluar, vetëm 6 nga 20 rekomandimet e dhëna ishin zbatuar plotësisht.

Komuna nuk e kishte hartuar planin strategjik dhe nuk kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilën mund të ballafaqohet komuna.

Planifikimet buxhetore duken të jenë të dobëta për faktin se vetëm 66% e të hyrave vetjake të planifikuara ishin mbledhur dhe vetëm (88%) e buxhetit për investime kapitale ishte shpenzuar. Si rezultat i mos menaxhimit të duhur të obligimeve, thesari sipas nenit 39.2 nga kategoria investime kapitale kishte ekzekutuar pagesa 443,416€ dhe nga mallrat dhe shërbimet 213,940€.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, si rezultat i mos zbatimit të rregulloreve përkatëse auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë prokurimin, të hyrat, pasuritë dhe llogaritë e arkëtueshme.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015 kishte rezultuar me 20 rekomandime, ku 18 ishin me prioritet të lartë dhe 2 me prioritet të mesëm. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Raporti i auditimit i vitit të kaluar nuk ishte diskutuar në asamblenë komunale.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, 6 (gjashtë) rekomandime janë zbatuar (4 me prioritet të lartë dhe 2 me prioritet të mesëm), 5 (pesë) rekomandime me prioritet të lartë janë në proces të zbatimit dhe 9 (nëntë) rekomandime me prioritet të lartë nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraparak - Prioritet i lartë

E gjetura 9 nga 18 rekomandimet me prioritet të lartë nuk janë trajtuar fare. Kjo për arsye se komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Si të tilla, në këtë raport auditimi, përsëri janë ngritur çështjet për përmirësim të aktiviteteve të caktuara.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- Qeverisje jo të mirë e cila redukton mundësinë që menaxhmenti të merr masa me kohë ndaj sfidave financiare, si dhe potencialisht mund të rezultojë me humbje financiare;
- Planifikim jo të mirë buxhetor;
- Menaxhimi jo i mirë tek të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale dhe
- Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlera e dobët për para në praktikën e prokurimit.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet pse rekomandimet e auditimit nuk po zbatohen dhe të vendos masa përgjegjësie ndaj të gjithë personave të ngarkuar me plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve. Pas finalizimit të këtij raporti, Kryetari duhet të përgatit Planin e veprimit me afate dhe aktivitete të qarta, dhe të përcaktoj personat përgjegjës për zbatimin në tërësi të këtij plani.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Konkluzionet tona nuk kanë për qëllim të komentojnë cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojnë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetësi i vet-vlerësimit të plotësuar ka vërtetuar se komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen e objektivave të përcaktuara;
2. Komuna nuk ka një Plan Strategjik Zhvillimor. Për më tepër, referoju nënkaptullit 2.3.1;
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit nuk janë bërë gjithëherë, sepse lidhen kontrata pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve; dhe
4. Progresi lidhur me monitorimin e objektivave nuk bëhet rregullisht dhe si rezultat i kësaj nuk analizohen shkaqet për dështimet e mundshme.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve dhe plani i zhvillimit strategjik. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të angazhohet për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Komunat janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal. Komuna kishte hartuar: strategjinë komunale për bujqësinë, dokumentin strategjik për zhvillimin e turizmit, hartimi i planeve për reagime emergjente, ka të hartuar planin urbanistik hapësinor.

Çështja 3 - Mungesa e Planit Strategjik Zhvillimor - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Komuna nuk posedon një plan strategjik gjithëpërfshirës me objektiva afatgjate ku përshkruhet qartë Vizioni dhe Misioni i cili prezanton orientimin dhe synimet e Komunës në një periudhë afatmesme të zhvillimit. Po ashtu, nuk ka të hartuar strategji kundër korrupsionit. |
| Rreziku | Mungesa e një plani strategjik gjithëpërfshirës rrezikon prioritetet e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e Komunës në periudha afatgjata. Paqartësia mbi zbatimin e strategjisë, bënë të pamundur që të përcillet përmbushja e objektivave në pikëpamje të vizionit të Komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë. |
| Rekomandimi 4 | Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën duke përfshirë koston e strategjisë, të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore. Të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave, duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes. |

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura Komuna posedon në formë të shkruar vetëm procesverbalet që rezultojnë nga takimet e Bordit të Drejtorëve dhe Kuvendi Komunal, ndërsa nuk ka raporte javore dhe mujore me shkrim të përgatitura nga drejtorët e drejtorive për Kryetarin ku do të duhej të përshkruhen aktivitetet operative dhe financiare.

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2016 Zyrtari Kryesor Financiar i secilës komunë i dorëzon Kryetarin të Komunës brenda tre (3) javëve nga mbyllja e secilit tremujor një raport të detajuar për progresin e arritur në zbatimin e të gjitha projekteve kapitale me vlerë më të lartë se 10,000€. Një kopje e raportit të tillë duhet t'i dorëzohet edhe Ministrit të Financave, mirëpo këto raporte nuk ishin përgatitur dhe dorëzuar sipas kërkesave ligjore.

Rreziku Mungesa e raportimeve të rregullta tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme për këtë. Po ashtu, të merr masa që raportimet nga ana e ZKF-së të bëhen sipas kërkesave ligjore për progresin fizik të investimeve kapitale.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë: drejtori i NjAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Komunës dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv. NJAB kishte planifikuar t'i kryej 10 auditime sipas planit vjetor (katër me rrezik të lartë, pesë me rrezik të mesëm dhe një me rrezik të ulët), ndërsa kishte arrit t'i përfundoj 9 prej tyre. Këto auditime kishin të bënin me aktivitetet e vitit 2015 dhe 2016. NJAB kishte bërë një punë të mirë duke audituar fusha me rrezik të lartë, siç janë: Të hyrat, Investimet kapitale, Mallrat dhe Shërbimet, Menaxhimin e pasurisë. Ne vlerësojmë punën e bërë nga kjo njësi dhe mund të konkludojmë se raportet ishin cilësore dhe të dëshmuara në mënyrë adekuate, ku kishin mbuluar aktivitete në proces, duke arritur të identifikojnë disa nga mangësitë në sistemet e kontrollit të brendshëm të komunës.

Çështja 5 – Adresim i dobët i rekomandimeve të NJAB – Prioriteti i lartë

E gjetura Ne kemi vlerësuar se si po zbatohen rekomandimet e NJAB nga menaxhmentit i komunës dhe kemi vlerësuar se ato vetëm pjesërisht ishin zbatuar. Këtë e vërteton edhe Raporti vjetor i kësaj njësie që e kishte dërguar në Njësinë Qendrore Harmonizuese tek Ministria e Financave.

Nevojitet një punë më cilësore dhe më e theksuar e komitetit në drejtim të shtyrjes së implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Rreziku Adresimi i dobët i rekomandimeve të NJAB-së nga menaxhmentit rritë rrezikun se kontrollet e brendshme nuk janë duke funksionuar në nivelin e duhur. Mungesa e angazhimit të komitetit të auditimit për ta shtyrë adresimin e rekomandimeve të NJAB-së rritë rrezikun që mangësitë të përsëriten vazhdimisht.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet marr të gjitha veprimet ndaj njësive administrative që u adresohen rekomandimet, që të kenë një përkushtim maksimal në marrjen e masave përmirësuese në fushat ku dobësitë janë identifikuar.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna ka të ndërtuar një sistem të kontrollit të brendshëm i cili në përgjithësi operon mirë, por efektiviteti i kontroleve ka nevojë të përmirësohet në disa fusha të caktuara ku janë identifikuar mangësi. Fushat ku nevojiten më shumë përmirësime janë: prokurimi, të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale, tatimi në pronë, planifikimi i buxhetit dhe realizimi i tij, menaxhimi i pasurive, raportimi i obligimeve të papaguara.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	9,480,000	9,480,000	6,292,849	5,276,000	5,353,482

Komuna nga të hyrat vetjake të planifikuara, kishte arritur që të inkasoj vetëm 66%. Në totalin e të hyrave vetjake të realizuara janë edhe të hyrat nga gjobat e trafikut (312,603) gjobat nga gjykata (179,485), nga pyjet (16,043). Arsyeja e një realizimi të ulët është se planifikimi i të hyrave ka qenë i dobët dhe nuk është bërë mbi bazat reale dhe të qëndrueshme.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	40,616,924	42,248,085	36,983,514	36,316,641	33,265,428
Granti i Qeverisë -Buxheti	31,136,924	31,037,090	30,767,839	30,671,904	28,783,661
Të bartura nga viti paraprak ³ -	0	1,370,905	1,345,624	1,537,404	753,697
Të hyrat vetjake ⁴	9,480,000	9,480,000	4,679,230	4,062,518	3,634,429
Donacionet e brendshme	0	210,421	84,038	28,956	37,796
Donacionet e jashtme	0	149,669	106,783	15,859	55,845

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ndryshon për 1,631,161€. Ky ndryshim ndërlidhet me shtimin e të hyrave të bartura nga viti paraprak (1,370,905€), donacioneve vendore dhe të jashtme (360,090€) dhe zvogëlimin e grantit të qeverisë (99,834€) në buxhetin final.

Në vitin 2016, komuna ka shpenzuar rreth 88% të buxhet final. Një shpenzimi i njëjtë ishte edhe vitin e kaluar. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm, dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	40,616,924	42,248,085	36,983,514	36,316,641	33,265,428
Pagat dhe Mëditjet	18,423,522	19,030,280	18,919,546	18,258,306	17,766,430
Mallrat dhe Shërbimet	3,125,019	3,083,195	2,807,989	2,448,555	2,477,087
Shërbimet komunale	1,081,200	1,065,171	762,688	751,705	864,971
Subvencionet dhe Transferet	477,615	512,179	325,767	334,608	521,614
Investimet Kapitale	17,509,568	18,557,260	14,167,524	14,523,467	11,635,326

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Nga tabela shihet se kemi një shpenzim të ulët nëpër kategori në krahasim me buxhetin. Për mallra dhe shërbime dhe komunalit ishte shpenzuar 86%, subvencione dhe transfere 64% dhe investime kapitale 76%. Arsyeja e një shpenzimi të ultë nëpër kategori ndërlidhet me planifikimin dhe realizimin e dobët të të hyrave vetjake. Mbi tre milionë euro të hyra vetjake të planifikuara për t'u mbledhur, nuk kanë mundur të shpenzohen për shkak të dështimit në inkasim.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Çështja 6 – Realizimi i dobët i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur tek të hyrat vetjake dhe shpenzimeve. Duhet potencuar se në shkallen (88%) e realizimit të buxhetit ka ndikuar edhe ekzekutimi i pagesave direkte nga Thesari (657,356€) sipas nenit 39.2 të LMFP.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i ulët i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin në vlerë 6,292,849€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale, taksa për regjistrimin e automjeteve, lejet e ndërtimit, të hyrat nga taksa administrative, etj.

Çështja 7 – Tatimi në pronë – Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 së pronave të paluajtshme siç kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Nga gjithsej 48,645 prona, komuna gjatë vitit 2016 ka arrit të verifikoj vetëm 1477 prona. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së zyrtarëve anketues në terren për verifikim të pronave.

Sipas nenit 9 të Ligjit mbi tatimin në pronë, çdo person fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore vendos se prona ose njësia e banimit i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës. Ne kemi identifikuar shtatë raste ku komuna nuk kishte vepruar në përputhje me ligjin për arsye se kishte tatimpagues që posedonin dy apo më tepër prona të regjistruara si banim kryesorë dhe për secilën pronë ju kishte aplikuar zbritja prej 10,000€ nga vlera e tatueshme e pronës.

Rreziku Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Mos aplikimi i ngarkesave sipas kërkesave ligjore të tatimit në pronë rrit rrezikun që të hyrat prej kësaj kategorie të jenë më të ulëta.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme. Gjithashtu, veprime shtesë duhet të ndërmerren për të siguruar se zbritjet për 10,000€ aplikohen në pajtim me nenin 9 të ligjit mbi tatimin në pronë.

Çështja 8 - Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna për pronat e dhëna me qira për 2016 kishte planifikuar që të realizoj 1,350,000€, ndërsa kishte arrit të inkasojë 501,328€ apo 37%.

Në vitin 2016 ishin bërë kontrata për shfrytëzimin e pronës komunale me çmim prej 1€ në muaj për 8 lokale disa partive politike, duke mos organizuar ankande publike siç kërkohet me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale. Këto lokale ishin dhënë duke u bazuar në vendimin e asamblesë komunale që ishte nxjerrë në vitin 2005.

Po ashtu, edhe 8 lokale tjera dhe një objekt pronë e komunës nuk ishte organizuar ankand publik nga komuna, përderisa ato shfrytëzohen nga disa Organizata Jo Qeveritare dhe parti politike pa kontrata.

Në dy raste qiramarrësit e shfrytëzojnë pronën komunale për tregje pa kontratë valide sepse kontrata ju kishte skaduar qysh në vitin 2013, dhe këta shfrytëzues vazhdojnë të ngarkohen me qira vetëm me një shkresë të Drejtorisë së shërbimeve publike të datës 10.11.2014. Këta obligues i kanë borxh komunës shumën 285,834€.

Në një rast komuna ka kontratë që nga viti 2009 me një operator për shfrytëzimin e tregut të gjelbër me qira mujore prej 180€ në muaj. Ne kemi vërejtur se operatori ekonomik nuk ka kryer obligimet sipas kontratës dhe nuk ka paguar asnjëherë obligimin ndaj komunës. Borxhi total kishte arritur në 14,580€. Më tutje, për rastet e përmendura, komuna nuk kishte organizuar ankande publike edhe pse Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale kishte hyrë në fuqi në vitin 2012.

Gjithashtu, në dy raste komuna me kontratë ka dhënë në shfrytëzim lokalet afariste, mirëpo qiramarrësit nuk i kryejnë obligimet sipas kontratës dhe borxhi i tyre arrin 3,534€.

Rreziku

Dhënia e pronës komunale me qira pa organizuar ankand publik paraqet rrezik të zgjedhjes së gabuar duke e kufizuar ofertën e tregut dhe dëmton parimin e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë për të gjithë të interesuarit. Po ashtu, shfrytëzimi i hapësirave publike pa kontrata valide mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronës komunale, rritë rrezikun që inkasimi i detyrimeve të mbetura të vijë në pikëpyetje apo edhe të mos inkasohen fare. Kjo mund t'i shkaktoj komunës humbje të konsiderueshme financiare.

Rekomandimi 9

Kryetari duhet të siguroj organizimin e ankandeve publike në rastet e dhënies me qira të pronave komunale në mënyrë që të ketë një proces të hapur dhe transparent, si dhe të ushtroj monitorim të vazhdueshëm tek shfrytëzimi i hapësirave publike në mënyrë që të mos shfrytëzohen pronat komunale pa kryer paraprakisht obligimet sipas kontratave të lidhura. Duhet vendosur edhe mekanizmat që pronat të mos shfrytëzohen pa pasur paraprakisht kontratë valide, të nënshkruar me komunën.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 19,030,280€, ndërsa shpenzimet 18,919,546€ apo 99%.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet dhe pagesat për anëtarët komunal. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës. Nga mostrat tona të testuar, nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për tu raportuar.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale ishte 4,148,366€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,570,677€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzimet komunale si: derivatet, furnizimet për zyre dhe ato mjekësore, shpenzimet kontraktuese, si dhe mirëmbajta e shkollave dhe ndërtesave, dhe riparimi i automjeteve etj.

Çështja 9 – Nënshkrimi i kontratës pa procedura të prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte lidhur kontratë për emetimin e seancave të kuvendit komunal me vlerë 150€ për seancë, duke mos respektuar procedurat e prokurimit. Nënshkrimi i kontratës ishte bërë direkt me OE pa udhëhequr procedurat e prokurimit paraprakisht. Pas këshillave tona në fazën e ndërmjetme, komuna menjëherë e ka ndërprerë kontratën.

Kemi vërejtur se në 22 raste Drejtoria e arsimit nuk i protokollon faturat e pranuar ashtu siç kërkohet me nenin 24 të Rregullës Financiare 01/2013 Për Shpenzimin e parasë publike.

Në tri raste komuna ka hyrë në obligime pa i zotuar të gjitha mjetet e nevojshme. Vlera këtyre kontratave të nënshkruara ishte 89,029€, ndërsa zotimi ishte bërë vetëm 11,000€.

Rreziku Hyrja në obligime pa siguruar mjetet e mjaftueshme, mund ta sjellë komunën në probleme financiare dhe buxhetore. Po ashtu, mos protokollimi i faturave rritë rrezikun se kontrollet e brendshme nuk kanë funksionar si duhet dhe faturat të mos paguhen me kohë apo të paguhen dy herë.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet se pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme, dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten, si dhe të gjitha faturat në momentin e pranimit, së pari të protokollohen dhe pastaj të procedohen më tutje për pagesë.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 512,179€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 325,767€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e entiteteve publike: klube të sportit, OJQ të ndryshme, shoqëri kulture artistike, etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 18,557,260€. Prej tyre në vitin 2016 ishin shpenzuar 14,167,524€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve, objekteve shkollore, bibliotekës së qytetit etj.

Çështja 10 - Kontrata me çmime për njësi dhe mungesa e projekteve ekzekutive - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte lidhur 3 kontrata publike kornizë për punë me çmim për njësi për mirëmbajtje për 36 muaj (Instalimi i ndriçimit publik, mirëmbajtja e rrugëve lokale me kubëza, intervenimi në infrastrukturë në rast të fatkeqësive natyrore) jo në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP) duke mos përcaktuar në dosje të tenderit sasinë indikative ose vlerën e parashikuar të kontratës. Sipas nenit 38 të LPP “Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)”. Mos përcaktimi i sasive ose vlerës së parashikuar në kontratë do ta bëjë të pamundur për të përcaktuar pragun e devijimit të lejuar me ligj.

Ne kemi vërejtur se te kontratat “Renovimi i Kulmit në QKMF” me vlerë 42,220€ komuna nuk kishte bërë hartimin e projektit ekzekutiv. Neni 28.10 i LPP-së për specifikimet teknike për kontratat për punë ndër të tjera thekson se “Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit, pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit”.

Rreziku Mos përfshirja e sasive të përafërta indikative në dosje të tenderit ose vlerës së parashikuar të kontratës paraqet rrezik potencial për manipulim me sasinë e nevojshme, dhe kryerjen e punëve me pozicione favorizuese për operatorin ekonomik (me çmime më të shtrenjta) dhe mos kryerjen e pozicioneve me çmime të lira. Kjo mund t’i shkaktoj humbje të konsiderueshme buxhetit të komunës. Po ashtu, zhvillimi i procedurave të prokurimit pa një projekt të hartuar paraprakisht mund të ndikoj që punimet e zbatuara në këto projekte të devijojnë nga kërkesat standarde të ndërtimit dhe të mos arrijnë cilësinë e duhur.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit përgatit dosjet e tenderit sipas kërkesave të LPP dhe specifikon qartë sasinë e përafërta indikative të punëve ose vlerën e parashikuar të kontratës. Po ashtu, të mos iniciohen aktivitete të prokurimit pa hartimin e projekteve ekzekutive.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PVF komuna kishte prezantuar pasuri mbi 1,000€ vlerën prej 474,589,000€ si dhe nën 1,000€ vlerën 921,000€. Auditimi jonë ka identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 11 - Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë jo në pajtim me rregulloren - Prioritet i lartë

E gjetura Komisioni për inventarizimin e pasurisë nuk e kishte përfshirë në raportin e tij gjithë pasurinë jo financiare të komunës, siç parashihet me Rregulloren 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare. Në këtë raport nuk ishte përfshirë inventarizimi i pasurisë së shkollave, qendrave të mjekësisë familjare dhe qendrës për punë sociale.

Përkundër se komisioni i inventarizimit kishte identifikuar pasuri të dëmtuara si dhe të vjetërsuara, ne kemi vërejtur se komisioni për vlerësimin e pasurisë nuk e kishte bërë vlerësimin e këtyre pasurive dhe nuk ka përpiluar raportin e vlerësimit deri në datën që ne kemi përfunduar auditimin me 17/03/2017. Neni 24.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Financiare thekson "Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare".

Rreziku Mos inventarizimit i gjithë pasurive komunale rrezikon që ajo të humb, të tjetërsohet apo të përvetësohet jashtëligjshëm. Po ashtu, moskryerja e raportit të vlerësimit me kohë sipas kërkesës së rregullores mund të ndikoj që pasuria e komunës të mos prezantohet drejt në PFV.

Rekomandimi 12 Kryetari të siguroj që komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë jo financiare do ta kryej punën në pajtim me rregulloren, duke përfshinë dhe vlerësuar gjithë pasurinë e komunës.

Çështja 12 - Mosfunksionimi i sistemit të E-Pasurisë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sistemi i e-pasurisë ende nuk funksionon plotësisht. Në e-pasuri regjistrohen vetëm materiali shpenzues i administratës së Komunës nga zyrtari i deponë mungesë të zyrtarit pranues/logjistikës të cilin komuna ende nuk e kishte rekrutuar, përkundër që ishte rekomandim në raportin e vitit të kaluar.
- Rreziku** Mos rekrutimi i zyrtarit pranues/logjistikës për regjistrimin e pasurisë rezulton në mosfunksionimin e plotë të sistemit të e-pasurisë dhe mundësinë e humbjes ose përvetësimit të pasurive të pa regjistruara.
- Rekomandimi 13** Kryetari duhet që të rekrutoj zyrtarin pranues/logjistikës në një afat sa më të shkurtër në mënyrë që sistemi i e-pasurisë të funksionalizohet plotësisht dhe evidencat e pasurisë të azhurnohen.

Çështja 13 - Mungesa e procedurave të brendshme për menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Neni 4.1 i Rregullores 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë financiare thekson se "Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare". Komuna nuk ka procedura të brendshme për menaxhimin e pasurisë.
- Rreziku** Mungesa e procedurave të brendshme për ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë mund të ndikoj që pasuria e komunës mos të menaxhohet si duhet dhe mos të prezantohet drejt.
- Rekomandimi 14** Kryetari duhet që të bëj hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare sipas kërkesës së rregullores 02/2013.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna nuk ka arritur t'i arkëtoj të gjitha borxhet për të cilat ka ofruar shërbime. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: tatimi në pronë, të hyrat nga tregjet, qiratë nga lokalet, taksat e aktivitetit të biznesit, si dhe shërbimet për mbledhje të mbeturinave. Mungesa e politikave adekuate dhe masave konkrete për mbledhjen e të hyrave, ka rezultuar me nivele të larta të llogarive të arkëtueshme.

Çështja 14 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e masave për mbledhjen e tyre - Prioritet i lartë

E gjetura Borxhet totale ndaj komunës, në fund të vitit 2016 ishin 15,567,347€. Borxhi kryesor mbetet inkasimi i tatimit në pronë në vlerë 6,808,003€, pastaj taksat nga veprimtaritë e biznesit 5,753,532€, të hyrat nga mbledhja dhe menaxhimi i mbeturinave 1,859,235€ nga dhënia me qira e tregjeve 455,577€, si dhe tarifatat tjera prej 691,000€. Krahasuar me vitin e kaluar (14,013,000€), llogaritë e arkëtueshme ishin rritur për 1,554,347€. Kjo është si pasojë e mos vendosjes së mekanizmave adekuat të inkasimit nga ana e komunës.

Rreziku Mungesa e masave konkrete për të inkasuar llogaritë e arkëtueshme, ka rezultuar me rritjen e këtyre llogarive prej vitit në vit, dhe rrjedhimisht, edhe me humbje financiare për komunën. Gjithashtu, kjo redukton edhe fleksibilitetin e komunës ndaj shpenzimeve të planifikuara që financohen nga të hyrat vetjake.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të shqyrtojë ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e realizimit të inkasimit të borxheve. Të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerrë shkaktarët e dështimit në pagesën e borxheve, si dhe të shfrytëzojë të gjitha mjetet në dispozicion, duke mos përjashtuar as masat administrative dhe veprimet ligjore.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 1,383,866€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Kjo vlerë e obligimeve të papaguara është rezultat i kontrolleve të brendshme të pamjaftueshme dhe hyrjes në obligime pa mjete të mjaftueshme.

Çështja 15 - Mos raportimi i obligimeve në pajtim me kërkesat ligjore - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Ne kemi identifikuar katër fatura të vitit 2016 (një faturë e muajit maj, dy fatura të muajit nëntor dhe një faturë e muajit dhjetor) me vlerë totale 51,594€, që nuk ishin prezantuar në raportin e obligimeve të papaguara dhe në PVF-të e vitit 2016.
- Rreziku** Mos prezantimi i obligimeve të papaguara në pajtim me kërkesat ligjore rritë rrezikun e një prezantimi të pasaktë dhe të pa drejt të obligimeve në PVF. Kjo gjithashtu, ndikon edhe në vendimmarrjen e menaxhmentit për t'i planifikuar dhe buxhetuar obligimet e bartura.
- Rekomandimi 16** Kryetari i komunës duhet të sigurojë që të gjitha faturat të raportohen drejtë në Ministri të Financave në pajtim me Rregullën e Thesarit 04/2011-Për raportimin e obligimeve të papaguara, në mënyrë që kjo të reflektoj edhe me prezantim të drejtë të obligimeve në PVF.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq-deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq-deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në theksim të çështjes për t'i hequr gabimet në klasifikimin e shpenzimeve si dhe për mos regjistrim të plotë të pasurisë. Është e nevojshme që të ndërmerren veprimet e duhura për t'i adresuar shkaqet që mund të ndikojnë në opinionin e auditimit, respektivisht të regjistrohen saktë të gjitha pasuritë kapitale.			Jo
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar dhe do të zbatohet në mënyrë rigoroze Plani i veprimit me aktivitetet specifike dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, duke i përcaktuar qartë edhe afatet kohore brenda të cilave rekomandimet duhet të zbatohen. Në fokus parësor të trajtimit duhet të jenë rekomandimet që prekin fushat më të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.			Jo
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit, si dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Auditimi i brendshëm e ka rishikuar listën kontrolluese të vetëvlerësimit, mirëpo edhe më tutje kjo listë nuk i përmban të gjitha kërkesat siç kërkohet me MFK. Si mungesa e listës për menaxhimin e rreziqe, mungesa e planit	

			strategjikë etj.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet sa më parë të miratoj një strategji të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, ku do të përcaktohet qartë qasja e menaxhmentit për reagime ndaj rreziqeve. Krahas identifikimit të rreziqeve në nivel operativ dhe strategjik, menaxhmenti duhet të hartoj edhe një plan veprimi ku përcaktohen masat e veprimit për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme.			Jo
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.			Jo
2.5.3 Plani strategjik i Komunës	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për Komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.			Jo
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të koordinoj bashkëpunimin me Komitetin e Auditimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm.		Rekomandimet e NJAB-it vetëm pjesërisht ishin implementuar nga menaxhmenti i organizatës.	
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku			Jo

	supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			
3.3 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj një shqyrtim të hollësishëm të të gjitha rasteve të përmendura më lartë për të analizuar pse kërkesat ligjore dhe rregullat e prokurimit nuk janë zbatuar, dhe pas shqyrtimit të rasteve, të merren masat e duhura. Gjithashtu, duhet vlerësuar pse kontrollet e çertifikimit kanë dështuar në parandalimin e pagesave të parregullta, siç ishte rasti me pagesat e derivateve.		Pjesërisht është implementuar nuk ka pasur raste kur komisioni i vlerësimit kishte eliminuar ofertuesit me çmim më të lirë, mirëpo edhe më tutje janë hasur kontrata që janë lidhur në mungesë të mjeteve.	
3.4 Shpenzimet jo përmes prokurimi	Kryetari duhet të kryej një rishikim të Kompensimeve/pagesave për komisione si dhe marrëveshjeve me institucionet tjera në mënyrë që të vërtetohet arsyeshmëria e tyre dhe të jetë në harmoni me ligjet e aplikueshme për të shmangur pagesat e pa arsyeshme.	Po		
3.4 Pagesat pa procedura të prokurimit	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuara për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në te ardhmen. Kryetari duhet të konsiderojë mundësinë e kontraktimit të një pako të vetme të shërbimeve të telefonisë mobile. Kjo do të siguronte çmime më të volitshme dhe do të ulte koston e shërbimeve telefonike.	Po		
3.4.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të siguroj që kontratat të nënshkruhen mbi bazën e kriterëve të qarta në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe konkurrues dhe të sigurohen paraprakisht kontratat e punës. Kontratat duhet të specifikojnë saktë shumën mujore dhe pagesat e pagave të jenë në harmoni me kontratat. Zyrtarët e personelit duhet të kompletojnë dëshmitë për përvojën e punës për të krijuar bazë ligjore për ekzekutimin e shtesës në bazë të përvojës.	Po		

	Kompensimi për mbajtjen e mësimit jo formal të bëhet në përputhje me rregulloren.			
3.4.2 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të rishikojë rastet e identifikuar për të siguruar që kontrollet në këtë fushë janë aplikuar sipas kërkesave, për të siguruar që mjetet janë përdorur për qëllimin e planifikuar dhe në pajtim me rregulloret.	Po		
3.5 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari i Komunës duhet të siguroj një proces të harmonizimeve të rregullta mujore ndërmjet drejtorive Komunale dhe administratës së financave, si dhe të vendos kontrolle të qëndrueshme që sigurojnë një planifikim të mirëfilltë dhe inkasim efektiv të të hyrave vetjake të Komunës.	Po		
3.5.1 Të hyrat nga sektori i mbeturinave	Kryetari duhet të sigurojë se do të kryhen analiza të mirëfillta të mos inkasimit të të hyrave nga menaxhimi i mbeturinave në mënyrë që të arrihen objektivat e Komunës në krijimin e sistemit të qëndrueshëm financiar. Po ashtu, të merret në konsideratë që paraprakisht të bëhen barazimet me OE dhe të mos kryhen pagesat ndaj atyre që kanë borxhe ndaj Komunës.		Inkasimi i të hyrave nga mbeturinat ka shënuar progres, mirëpo edhe më tutje më tutje kompanitë që merren me menaxhimin e mbeturinave kanë borxhe ndaj komunës.	
3.5.2 Dobësi në kontratat e koncesioneve dhe qiradhënies	Kryetari duhet të shqyrtoj arsyet e gjendjes ekzistuese dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhe të arsyeshme të inkasoj të gjitha borxhet e prapambetura, ose në të kundërtën, të ndaloj shfrytëzimin e pronave publike pronarëve, të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj Komunës.			Jo
3.5.3 Fituesi i ofertës për	Kryetari duhet të siguroj që me rastin e shpalljes se ankandeve publike, pjesëmarrësit paraprakisht të kushtëzohen më sanksione nëse tërhiqen pas	Po		

shfrytëzimin e lokaleve afariste me çmim me të ulët	hapjes se ankandit publik dhe të respektoj Rregulloren për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike përmes ankandit publik.			
3.6 Pasuritë dhe detyrimet	Kryetari duhet të rishikojë pse pasuritë e identifikuar nuk janë regjistruar në sistemin e-Pasuria, dhe të adresojë dobësitë që kanë të bëjnë me azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrimit të pasurisë. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.			Jo
3.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari të shqyrtojë ngritjen e një grupi pune të veçantë për shqyrtimin e realizimit të inkasimit të borxheve, në veçanti rritjen enorme brenda një viti të llogarive të arkëtueshme nga shërbimet për mbledhje të mbeturinave. Gjithashtu, të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve, si dhe të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë edhe veprimet ligjore.			Jo
3.6.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingjente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të Komunës, duhet të ndërmerret një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, për të evituar rrethanat të cilat mund shkaktojnë pagesën e tyre drejtpërdrejt nga MF apo edhe sipas vendimeve gjyqësore.		Komuna pjesërisht e ka adresuar këtë rekomandim nuk ka pasur raste ku pro faturat të prezantohen në PVF si obligime të papaguara, mirëpo edhe më tutje nuk ka arrit t'i menaxhoj obligimet në nivelin e kënaqshëm për arsye se shumica e obligimeve është e lartë.	

Shtojca IV: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

DATE:	02.05.2017
REFERENCE:	Zyrtarisht
PËR:	Lavdim Maxhuni Udhëheqës Ekipi nga Zyra Kombëtare e Auditimit
CC:	Florim Beqiri Drejtor i Departamentit në Zyrën Kombëtare të Auditimit
PERMES:	Prof. Dr. Ramadan Mita Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA:	Ertan Simitci, Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi e Financa
LËNDA/TEMA	LETËR E KONFIRMIMIT - Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare Komunës së Prizrenit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet, si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Me respekt!